



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Mbledhja nr. 25/2008

Më 17.11.2008, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-225

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani- kryetare e komisionit, Ethem Çeku, Haki Shatri, Kaqusha Jashari, Safete Hadergjonaj, Fatmir Rexhepi, Zef Morina, Sala Berisha – Shala dhe Berim Ramosaj.

Munguan: Slobodan Petroviq dhe Múfera Şinik.

Pjesëmarrës tjerë: Ahmet Shala ministër Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, Sagita Muço dhe Besim Zeqiri-ICO; Blerina Uka nga NDI, Haxhi Gashi nga USAID dhe Valmir Ismajli nga KDI-ja.

Nga Zyra Mbështetëse: Hasan Tahiri, Advie Morina, Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Nurie Morina;

Mbledhjen e drejtoi: Myzejene Selmani-.kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 12.11.2008;
3. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë së Republikës nr. 03/38 të dt. 2 tetor 2008, lidhur me fillimin e procedurave të privatizimit të distribuimit dhe furnizimit të KEK-ut.
4. Të ndryshme;

I. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

II. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 12 nëntor 2008;

Procesverbali i mbledhjes së datës 12 nëntor 2008, u miratua pa vërejtje.

III. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë së Republikës nr. 03/38 të dt. 2 tetor 2008, lidhur me fillimin e procedurave të privatizimit të distribuimit dhe furnizimit të KEK-ut.

Myzejene Selmani (kryetare e komisionit) – i'a dha fjalën ministrit Ahmet Shala, ministër i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (në vijim MEF) për të sqaruar nismën që kanë të bëjnë me procesin e privatizimit e distribuimit dhe furnizimit të KEK-ut.

Ahmet Shala (ministër i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave)- diskutimin e tij për sqaruar nismën që ka të bëjë me procesin e privatizimit të Kompanisë së distribuimit dhe furnizimit të KEK-ut, ai tha se Qeveria e Kosovës ka vendos që përfundimisht me buxhetin e vitit 2009, subvencionet për KEK-un të jenë të fundit, në mënyrë që sektori i energjisë elektrike të jetë një sektor i cili prodhon qëndrueshmëri politike dhe stabilitet ekonomik të furnizimit me rrymë, qoftë amvisnin apo biznesin, ku të gjitha studimet e deri më tashme edhe në të kaluarën pra që nga viti 2000, të bërë nga FMN-ja, apo nga Banka Botërore, qoftë nga Qeveritë e kaluara të Kosovës, por sidomos nga Institucionet profesionale që merren me KEK-un, tregojnë se i vetmi shpëtim për të mundësuar furnizimin stabil të energjisë elektrike dhe për të përmbushur nevojat për investime në rrjet, që sipas kërkesave buxhetore të KEK-ut, kalon shifrën prej 200 milion euro, në vitet e ardhshme duhet të hapen dyert me kujdes sektorit privat. Ai shtoi se sigurisht kur flasim për privatizimin e KEK-ut, edhe për privatizimin e sektorëve tjerë strategjikë të Kosovës, duhet të jemi tepër të kujdesshëm në mënyrën se si do ta privatizojmë. Ai njoftoi se para një kohe është shpallë tenderi për kompanin këshillëdhënëse, afati i përmbylljes së kushteve për këtë kompani është deri me 10 dhjetor 2008, dhe shfrytëzoj rastin të ftoi kompanitë më të fuqishme ndërkombëtare për të konkurruar që ta këshillojë Qeverinë e Kosovës, natyrisht ata do kenë obligim për të biseduar edhe me këtë Komision, për të konsultuar edhe KEK-un, për të konsultuar edhe praktikantët më të mira regjionale dhe ato botërore me qëllim që të kemi një model i cili reflekton në specifikat që ka Kosova. Mirëpo ai tha se është ende herët për të fol sot në këtë Komision se cili do jenë modaliteti e privatizimit të KEK-ut, a do të privatizohen 100% të aksioneve apo një pjesë e tyre, a do të ruhet, apo përmes ndonjë forme me aksionin e artë ndonjë e drejtë e shtetit të Kosovës, ndaj ndonjë elementi të veçante për të ruajtur pozicionin ndaj këtij sektori apo formë tjetër të klauzurave të veçanta në tender edhe në kontratë, dhe janë të gjitha këto që do të diskutojmë bashkërisht me MEM-in, me ekspertët e ndryshëm ndërkombëtar qofshin ata të USAID-it, qofshin të BB, të KE, pra është vetëm hapi i parë drejt shumë hapave për të ardhmen. Ai poashtu i njoftoi deputetet se MEF u ka shpërnda një material për këtë çështje, ku tregohen se synimi është që deri në fund të vitit 2009, të përmbyllet çështja e privatizimit të KEK-ut. Ai shfaq shqetësimin lidhur më numrin e madh të të punësuarve në KEK, por garantoi se do të jenë tepër të kujdesshëm se si do të draftohet tenderi. Ai njoftoi se një ndër elementet që ka futur në buxhetin e vitit 2009, është edhe kontrat për hua, të cilën KEK-u, e ka kërkuar në minimumin e kërkesave të tyre prej 80

milion euro, për investimin në miniera dhe në gjenerim të energjisë elektrike, ai tha se kan propozuar që kjo kontratë të bartet gjatë vitit të ardhshëm të blerssi eventual i KEK-ut, apo te blerësi i Kosovës së Re, si dhe kontrata e vitit të kaluar për elevatorët. Ai theksoi se këtu dhe do jenë tepër këmbëngulës që shifra prej 80 milion euro, do ti bartet si kredi KEK-ut, për vitin 2009. Kjo ka qenë një nga temat jo të lehta për të diskutuar me KEK-un në mënyrë që ti ipet mundësia KEK-ut, që në vitin 2010 më pastaj të ketë mundësi që kushdo që të vijë në KEK për të prodhuar ose në Kosovën e Re ti kenë minierat e gatshme. Vendimi i Qeverisë për privatizim ka qenë në fillim të muajit tetor, emërimi i komisionit për privatizim konform Ligjit mbi menaxhimin e ndërmarrjeve publike, janë pesë anëtarë sipas Ligjit kryesues i komisionit për privatizim duhet jetë MEF, MTI, MEM në këtë rast dhe dy ministra njëri i cili do të jetë nga përfaqësuesit e minoriteteve, ky komision në një nga mbledhjet e kaluara i ka aprovuar termat e referencës për kompaninë këshillëdhënëse dhe ka botuar në gazetën ndërkombëtare. Ai informoj se në fund të janarit eventualisht në mes të shkurtit të vitit 2009, duhet të shpallet tenderi për shprehjen e interesit për kompanitë të cilat do jenë të interesuara që të marrin pjesë në investimin e privatizimit të KEK-ut. Në muajin mars, deri kah fundi i prillit të vitit 2009, parakualifikimit të kompanive të cilat kanë konkurruar edhe në maj, qershor 2009, do ti draftojnë termat përfundimtare të tenderit, duke shtuar se kur po flitet për privatizimin e KEK-ut, tenderi do të shpallet diku në muajin maj apo qershor të vitit 2009, deri atëherë këshilltarët e transaksionit duke i konsultuar të gjitha rrethanat, të gjitha institucionet, të gjitha studimet do hulumtojnë secilin nga specifikat që i përkasin këtij sektori dhe natyrisht kësaj fushe të kësaj kompanie. Duke shtuar në fund se ekziston një projekt i cili është kërkuar nga KEK-u, mbi 50 milion euro e të cilit në vitin e ardhshëm do kemi mundësi të japim vetëm një sasi tepër të limituar aq sa ka mundësuar buxheti i Kosovës për përmirësimin e rrjetit të këtyre orëve, është projekt tre vjeçar, natyrisht që interesimi është që këtë projekt ta kryej sektori privat, por kërkesat mbi 200 milion euro për investime kapitale në rrjet, nuk do ishte shumë e logjikshme, kur kemi një ankesë të arsyeshme të qytetarëve të Kosovës, që paratë e taksapaguesve të Kosovës të orientohen në ato segmente ku sektori privat nuk është i interesuar të hyj siç janë problemet sociale, infrastruktura rrugore, infrastruktura e ujit, arsimit, përmirësimi jo vetëm i objekteve shkollore por edhe të tjerave elemente, njëherit z.Shala tha se sipas Ligjit mbi ndërmarrjet publike, para se të nënshkruhet kontrata kemi nevojë një mbështetje nga Kuvendi i Kosovës.

Kryetarja – pas përfundimit të diskutimit të ministrit Shala, hapi diskutimin në Komision.

Fatmir Rexhepi – diskutimin e tij e filloj duke vlerësuar takimin por edhe vazhdimin e ndërtimit të politikave të cilat do të jenë vërtet në funksion të stabilizimit të kësaj gjendje e cila është mjaft e rënd. Ai tha se krejt kjo është që detyrohen si deputet dhe si qeveritar të mendohet mirë, të punohet mirë, dhe të menaxhohet me këtë pasuri dhe ndërmarrje publike me shumë seriozitet dhe më transparenc në të gjitha fazat. Ai tha se pajtohet më atë së çfarë tha ministri, lidhur me ecurinë e më tutjeshme, sepse çdo njërin e preokupon privatizimi i këtyre ndërmarrjeve, deshiron ta sheh secili hisen e shtetit të vet, shtetit të ri por të gjejmë praktikën dhe modalitetet ku në këtë pasuri do të kemi edhe më tutje hisen tonë si shtet i ri në mënyrë që ti gëzojmë ato të mira që nesër pas privatizimit në formën më të mirë të mundshme të kemi edhe hisen tonë. Z.Rexhepi propozojë që një agjendë e

hartuar mirë së bashku me këtë komision po edhe me parlamentin, dhe për fazat e më tutjeshme të këtë debate, në mënyrë që të gjitha rekomandimet, të këtë një transparencë para opinionit, pra kjo kërkon një përkushtim dhe një qasje më të mirë, duke përfunduar më kokluzionin se në këtë funksion e përkrah iniciativen e Qeverisë, mirëpo nuk ishte idhëtar që të nxirren vendime të parakohshme të ngutshme që ta sjellin Kuvendin para akteve të kryera, por të jetë vërtet me një bashkëpunim i mirë dhe korrekt në të gjitha fazat të mirren informatat me kohë.

Berim Ramosaj – theksoj se në parim e përkrahë privatizimin e KEK-ut, duke shtuar se çdo arsyeshmëri e sektorit publik, do ta gjëjë përkrahjen kur është fjala për privatizim të KEK-ut, Duke iu referuar dokumentit të ofruar nga MEF-i, ai tha se ka shumë elemente të natyrës së arsyeshmërisë të keq menaxhimit edhe të kompanisë edhe të mangësive që ekzistojnë edhe sot në sektorin e energjetikës Z.Ramosaj ishte i preokupuar edhe më atë se nuk mund ta arsyetojë keq menaxhimin e KEK-ut, në procesin e privatizimit ajo nuk mund të arsyetohet dhe konsekuencat e privatizimit të këtij sektori të shpërnadrjes janë aq të mëdha në degët tjera në fusha tjera të energjetikës që në këtë dokument nuk janë paraqitur, dhe është paraqitur vetëm ndikimi që e ka Kosova e Re. Në përfundim të diskutimit të tij ai tha se në këtë periudhë të krizës globale energjetike, a mund të jemi ne joshës të ndonjë investitori të huaj të fuqishëm në këtë drejtim, edhe këtu ne duhet me shiku në këtë aspekt a jemi të interesuar vetëm sa me shitë distribucionin apo me fituar para prej distribucionit, për të gjitha këto çështje të hapura kërkoj të krijohet jo vetëm ministri por Qeveria të krijoj një platformë të arsyeshmërisë për efikasitetin dhe efektivitetin e këtij sektori.

Kryetarja – theksoj se si ligjvënse dëshiron të dijë se sa i plotëson kushtet Ligji për Ndërmarrjet Publike, për privatizimin e ndërmarrjeve publike, ku nuk është një ligj shumë i qart, është një ligj ku të gjitha kompetencat edhe ministrive të linjës drejtohen të MEF-i, që të thotë se është bërë një centralizim i kompetencave të gjitha ministrive, të linjave të MEF-it, ku vetëm dy nene të këtij ligji të japin mundësi për çështjen e privatizimit, ndërsa ministri ka qenë edhe në kohën e më parshme përfaqësues në AKM-së, ku me rregulloren e UNMK-ut, e cila e ka potencua mjaft mirë procedurën përgjithësitë, ecuritë, rolin dhe metodat e punës të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore. Dhe ishte e mendimit që më mirë është të adamentohet ligji, dhe pastaj do të dihet se si do të shkoj procedura e privatizimit e ndërmarrjeve publike veq e veq apo duhet të nxjerrët një ligj tjetër për modelet e privatizimit të kompanive publike, kur dihet mjaft mirë se me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 160, jep shumë qartë që kompanit publike janë pronë e Republikës së Kosovës, të cilën e menaxhon Qeveria. Pastaj pyeti se a ka Qeveria mënyrë më të qartë një strategji zhvillimore me interes nacional për të mira të qytetarëve të Kosovës lidhur me privatizimin e kompanive publike. Në përfundim tha se do të ishte mirë që të shfrytëzojm eksperiencat e ekspertve të huaj kryesisht të USAIDA-it, kështuqë të gjindet pervoja, metoda apo modeli me i mirë për privatizimin e ndërmarrjeve publike.

Kaqusha Jashari – tha se do të ishte gabim sikur mos të kemi kujdes të mirë është që të ia japim dikujt që të merret me probleme tona, dhe pastaj të shpëtojm ne, dhe po tregohet së çdo vit edhe donacione edhe buxhet, më këto të holla, me mbi 600 milion euro, do të

ndërtohej një i ri p.sh. hidrocentrali i Zhurit. Ajo shtoj se ai i cili e merr distribucionin nuk e di se a mundet me disiplinua rendin dhe a mundet me investuar aq që është prodhimi, që shpenzohet maksimalisht, dhe ishte e mendimit se këtu duhet me qenë arsyeshmëri profesionale shumë e mirë të inkuadrohen njerëz tonë, nese kemi duke u pajtuar që duhet me qenë këtu një kompani këshilluese, mirëpo më gjithë respektin për ekspertët e huaj. Dhe propozoj që të sqarohet mirë politika se sa është strategjia jo vetëm te KEK-ut, por edhe kur vijnë edhe palet tjera, duke iu referuar kryetares për ligjshmërinë, duke shtuar se për metodologjinë e privatizimit, ajo është diçka tjetër, por ajo e respektoj strategjinë që është aprovua sepse nuk është Kuvendi i ri që duhet të fillojë prej zeros por ka nevojë për disa shpjegime.

Ethem Çeku – duke vlerësuar sektorin e energjisë si çështje të ndjeshme për shkak të zhvillimeve të kaluara, ai tha se është njëri ndër sektorët bazë për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Duke u ndalur në strategjinë, si tha se ajo po rinovohet dhe mirë që po rinovohet sepse e ka anën ligjore mirëpo duhet shikohet edhe strategjia në afat kohor me zhvillimet që po bëhen. Duke shtuar të situata financiare ai tha se është krye pjesa e ndarjes juridike të shthurjes së KEK-ut, mirëpo nuk ka shkuar në atë që e kërkoj Berim Ramosaj, deri në fund ka mbet, është vetëm KOST-i, që është edhe vi e ndarjes buxhetore kurse sektorët tjerë nuk janë nda në vija buxhetore dhe janë ende në një shtëpi të përbashkët, dhe këtë preojkt duhet ta vazhdoj qeveria, shthurjen e plotë në baza financiare. Ai shtroi pyetjen se a është koha se pse duhet tani të privatizojmë distribucionin, a është koha e përshtatme për privatizim të tanishëm, duke u bazuar në pervoja të shteteve tjera si në Maqedoni dhe Shqipëri, ku kanë pasur rezultate të mira dhe jo të mira, ku edhe pengesa në zhvillimin e privatizimit të distribucionit, prandaj pervojat tregojnë se shteti, duhet të jetë tepër e kujdesshme sa i përket qështjes së privatizimit të distribucionit. Në fund të diskutimit dha iden që qeveria duhet të vendos një tryeze të rrumbullaket, ku të trajtohen këto çështje, aty mund të plasohen idetë, sugjerimet, ku njerz të institucioneve, eksperte mund të japin kontributin e tyre.

Haki Shatri – theksoj së në parim nuk është kundër privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore edhe për sektorin publik dhe këtu në parim ka një mbështetje për fillimin e procesit të privatizimit. Ai ishte i mendimit që sot mund ti ipet mbështetje vendimit të qeverisë për përfundimin e procesit të korporatizimit të KEK-ut. Vendimi për procesin e korporatizimin e KEK-ut, e ndarjes së KEK-ut, në njësi të veçanta me bilance të veçanta do të krijoj parakushte për fillimin e privatizimit të cilës do njësi të KEK-ut, parakushtet të krijohen dhe pas kësaj ose paralelisht të kemi studime, materiale për të cilat do të kemi një pasqyrë reale të gjendjes së njësisë të distribucionit, tha z.Shatri. Ai potencoi si çështje d.m.th subvencionimin ose ndarjen në pjesë të tjera që janë parapa me buxhet që edhe në këtë vit, po jepen edhe kredi edhe për minierat, për minierën e Sibofcit 80 milion euro është parapa që të jepen, edhe 80 milion tjera si hua kredi, tash nese e bëjmë korporatizimin dhe pas korporatizimit ne deshirojmë me shit një pjesë ajo pjesë nuk i ka shfrytëzua këto kredi, qysh ia ngarkojmë blerësit të një njësie të ndarë borgjin e një njësie tjetër. Poashtu ngriti çështjen e rishqyrtimit të strategjisë së sektorit por edhe për privatizimin e një pjese, dhe shfaqti shqetësimin së nuk janë hapa të rënditur mbarë sepse është dashur të përfundoj procesi i strategjisë.

Zef Morina – duke iu referuar matrialit të sjellur nga MEF-i, ai tha se shihet shumë qartë se nuk do të bëhet menjëher por është një procedurë e cila sigurisht do të kaloj nëpër etapat e veta duke përfshirë procedurat dhe të gjitha qështjet teknike se si do të ndodhin ato që sigurisht ekspertët dhe grupet punuese të komisionit do ti mbarojnë gjë që ne nuk kemi dyshim aspak në këtë drejtim ajo që për ne është shumë me rëndësi d.m.th që vet hapi i parë drejt privatizimit të këtijë sektori ka zgjua një interes te qytetarët. Ajo që e preokuponte z.Morina ishte se pavarësisht që kjo është e domosdoshme a është qëllimi i privatizimit siç e ceku z.Ramosaj, sa para do të fitojmë me privatizim apo sa do të kemi energji si Kosovë si qytetar pas privatizimit. Në fund të diskutimit të tij ai e përkrahu vendimin e qeverisë dhe dha sugjerimin që nëse vërtet privatizimi do të ndodhe, Qeveria ta këtë përqindjen e vet dhe vendimin pavarësisht situatave që do të ndodhin.

Safete Hadergjonaj – theksoj se Qeveria ka marr vendim për të bërë shthurjen e KEK-ut, dhe ajo është në proces e sipër, transformimin, ristrukturimin është në përfundim e sipër. Ajo iu referua kohës, se a është koha e përshtatshme, ne në këtë moment po e shohim një krizë globale në tregun financiar, mirëpo Qeveria është duke e përcjell rrjedhën e këtyre proceseve dhe ishte e bindur që vendimin do ta merr në kohën e nevojshme dhe mënyrën e nevojshme që mos të ndikoj kjo në tregun financiar në procesin e privatizimit të KEK-ut. Duke shtuar se qeveria nuk është fajtores në këtë moment Kuvendi e ka miratuar Ligjin për ndërmarrjet publike, kur ai ligj ka qenë miratim i pakos së Ahtisarit, mirëpo kemi edhe një vit dhe pritet që në të ardhmën të amendamentojm mirëpo ne i njohim rrethanat në të cilat jemi. Ajo tha se është detyrë e jona që të punohet dhe ti përfundojmë procedurat e tjera të cilat janë të domosdoshme në këtë proces siç është Ligji për shpronësim, si dhe Ligji për koncesione dhe partneritet privato-publik, të cilat janë në shqyrtim e sipër tha në fund z.Hadergjonaj duke i japur mbështetje të fuqishme vendimit të qeverisë për vendimin e qeverisë për fillimin e procedurave të privatizimit të KEK-ut.

Sala Berisha-Shala - tha se një ndër arsytet e privatizimit të distribuimit ishte menaxhmenti i dobët i KEK-ut, të sistemi i vjetër i menaxhimit të ndërmarrjeve nga rrethanat e krijuar tash në rrethana të reja ekonomike politike. Ajo shtoi se dihet që Kosova e ka një nga rezervat më të mëdha të thënshillit në Evropë, mirëpo e dijmë që termocentralet ekzistuese nuk i plotësojnë standardet mjedisore të cilat kanë shumë rëndësi që është një standard që duhet ta plotësoj Kosova për tu futur në BE, dhe termocentralet janë prodhim i ndotjes së gjërë të cilat e kanë një diametër edhe jashtë Kosovës, e cila kjo është e pa lejueshme, përfundoj diskutimin e saj znj.Berisha – Shala.

Fatmir Rexhepi ishte i mendimit që viti 2009 të jetë vitë i testimit të privatizimit të ndërmarrjeve publike, dhe të këtë një orgaizim të ri të korporatizimit, ndërsa më 1 janar të vitit 2010, të kemi një bilanc të këtyre korporatave dhe të shohim së çfarë performace kan arrit këto korporata.

Ethem Çeku – tha se po apostrofohet vazhdimisht nga e kaluara, ai shtoi vetëm se do ta mbështeti në parim propozimin e qeverisë, duke vlerësuar këtë hap të sotëm, që është në kohën, që normalisht ekspertet ti vlersojen para se ta marrim vendimin e hyrjes se

kapitalit te jashtëm, paralelisht në disa drejtime që të kemi rritjen e performances, dhe propozoj që duhet të krahasuar përvijat e Shqipërisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë.

Berim Ramosaj – duke qëndruar strikt pran qëndrimit të tij ai tha se në material janë gërshetua dobësitë edhe të njësisë të tjera që në fakt e shtyn për me hy në këtë proces. Ai deshi të dij se distribucioni i KEK-ut, sa e ka anët e forta dhe sa i ka anët e dobëta sepse nuk mundemi me bërë skvot analizën për KEK-un, ne gjendjen katastrofike dhe në arsyeshmërin e kësaj gjendje të bëjmë distribucionin. Duke vazhduar se duhet më ditë performancën e njësisë organizative për me hy në privatizim minimum një vit. Ai poashtu shprehu se ka vërejtje ordinere që thjesht nuk është shthurja rikrustuim, operatizim dhe kërkoj që të gjindet një shprehje më të mirë, dhe të ceket se kush i bënë këto shthurje, sepse është diçka tjetër rikruestuim është krejt një koncept tjetër.

Sala Berisha-Shala – duke iu referuar diskutimit të deputetit Rexhepi, ajo që e nxiti të diskutoi ishte se të jetë një viti testues i korporatave viti 2009, ku do të shihej se çfarë performancash kanë ato njësi, sigurisht që secila i ka specifikat e veta dhe nuk mund ta kenë peshojën e njejtë, sikur distribuomi, si sigurimi fizik, mirëpo duke i realizua përfaqësisë dhe dobësitë e secilës do të dalim deri te një rezultat përfundoj znj, Berisha-Shala.

Pas debatit të gjerë Komisioni nxori këtë:

Përfundim

-Mbështetet në parim, nisma e procesit të privatizimit të distribuimit dhe furnizimit të KEK-ut, duke përcaktuar prioritetet në kuadër të procesit të privatizimit, si vijon:

Së pari duhet të realizohet-përfundohet transformimi i plotë organizativ i korporatizimit të KEK-ut, duke i përcaktuar statusin formal-juridik të secilës njësi në kuadër të Ndërmarrjes publike të KEK-ut;

Viti 2009, duhet të jetë vit testues, gjatë të cilit duhet të përcillen dhe analizohen parametrat (afarizmi ekonomik), efektet ekonomike për secilën njësi veç e veç, dhe Procedurat e privatizimit të fillojnë, varësisht nga rezultati i fizibilitetit –(konkluzioneve analitike në aspektin ekonomik), me kusht që privatizimi i njësisë së caktuar, të jetë prioritet dhe përparësi ekonomike për vendin;

-Në vazhdim, komisioni formoi grupin punues prej Berim Ramosaj, Haki Shatri dhe Ethem Çeku për të hartuar Rekomandimin për Kuvend, në bazë të përfundimit të mbledhjes, e që duhet të miratohet në mbledhjen e radhës nga Komisioni.

IV Të ndryshme;

Kryetarja – i njoftoi anëtarët e Komisionit që amendamenti i Ligjit për shpronësim do të shqyrtohet në mbledhjen e radhës nëse USAID-i, është i gatshëm të sjellë vërejtjet e tij për këtë Ligj.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30;

Kryetare e Komisionit;
Myzejene Selmani